

Shkolla e Lartë Nehemiah Gateway - një strukturë arsimore dhe kërkimore e Grupit Nehemiah Gateway në Shqipëri

SHIFRA DHE FAKTE

- Qëllimi:** Qëllimi i Shkollës së Lartë Nehemiah Gateway është të edukojë të rinj të talentuar. Theme-luesit e saj punojnë për kompanitë, OJQ-të ose për administratën publike. Studentët gjithashtu kanë mundësinë për të ndërmarrë veprime për organizatat partnere dhe ndihmëse të Grupit Nehemiah Gateway.
- Fillimi:** Universiteti mori në vitin 2008 licencën nga qeveria shqiptare. Studentët e parë filluan studimet e tyre në janar të vitit 2010. Universiteti ka dy fakultete: Fakulteti i Shkencave Humane dhe Fakulteti i Biznesit dhe Teknologjisë.
- Programe studimi:** Aktualisht ka dy programe studimi Së pari, Bachelor në Ekonomy and Businesses“ (pesë kurse studimi, një total prej 24 të diplomuarish dhe 41 studentë), së dyti, Master i Shkencave në „Leadership and Assessment in Education“ (dy kurse studimi, një total prej 16 të diplomuarish dhe 11 studentë). Një kurs studimi për B.A. pritet në janar 2017 dhe për M.Sc. fillojnë në tetor 2016. Shkalla e punësimit të të diplomuarve tanë është 82.5%, ndërsa 12.5% e të diplomuarve kërkojnë studime të mëtejshme dhe 5% për arsye familjare nuk janë duke punuar.)
- Bashkëpunëtorët:** Grupi i studentëve në Shkollën e Lartë Nehemiah Gateway është ndërkombëtar. Ata vijnë nga Shqipëria, Gjermania, Greqia, nga disa vende afrikane si Uganda, Sudani i Jugut dhe Tanzania, si dhe nga Amerika Latine; Meksika. Më shumë se 70 për qind e stafit akademik vijnë nga vendet e Europës Perëndimore si Gjermania, Zvicra, Britania e Madhe dhe SHBA. Në këtë mënyrë lektorët e huaj sjellin gjetjet e fundit në hulumtim dhe mësimdhënie, të cilat implementohen në kontekstin shqiptar nga punonjësit vendorë .
- Akreditimi:** Shkolla e Lartë Nehemiah Gateway është i vetmi universitet në Shqipëri dhe në Ballkanin Perëndimor që ka përfunduar me sukses akreditimin në Shtetet e Bashkuara. Të dy programet e studimit janë akredituar në Gjermani. Programi bachelor është i akredituar edhe në Shqipëri, ndërkohë që programi master është ende në procesin e akreditimit në Shqipëri.
- Fokusi:** Fokusi është përqëndruar në integrimin e teorisë dhe praktikës, veçanërisht në programet e sistemit dual. Në këtë mënyrë studentët mund të ndihmohen për të gjetur punë dhe të kenë sukses. Praktika e studentëve është bërë e mundur nga partnerët e organizatës në Shqipëri, Gjermani, Zvicër, Ugandë, Tanzani dhe Meksikë.
- Planet e zhvillimit:** Shkolla e Lartë shërben gjithashtu edhe si një qendër trajnimi. Të interesuarit mund të kualifikohen ose të përgatiten për të ardhmen si pjesë e një trajnimi ose arsimit përmes praktikave. Shkolla gjithashtu ka për qëllim pajisjen e drejtuesve të ardhshëm me metoda moderne të të mësuarit interaktiv. Kjo është bërë përmes përdorimit të Laboratorit të Studimit me partnerët ndërkombëtarë dhe është e shoqëruar nga një grup i vogël kërkimor.

Studentët e Shkollës së lartë „Nehemiah Gateway“



Eduart Gjona
23, Shqipëri, Fakulteti i Biznesit dhe Teknologjisë

Ne kemi profesorë nga e gjithë Evropa, SHBA madje edhe nga India. Kështu që unë njoha që në fillim të menduarit dhe të punuarit ndërkombëtar në Shkollën e Lartë „Nehemiah Gateway“. Unë mendoj se kjo është shumë e rëndësishme për shkak se shumica e kompanive janë të pozicionuar ndërkombëtarisht sot. Gjatë studimeve të mia unë kam të bëj me njerëz nga kultura të ndryshme me ide të ndryshme. Ata më japin përvojën, të cilën do ta kisha vështirë ta arrija më vonë, kur të filloj punë



Haleluya Johanes Kasimbazi
23, Tanzania, Fakulteti i Biznesit dhe Teknologjisë

Më pëlqen Shkolla e lartë Nehemiah Gateway për sistemin dual. Këtu unë mund të fitoj përvojë që do të jetë ndihmë e madhe për mua në të ardhmen në punë. Ky është një ndryshim themelor nga universiteti im në Afrikë. Akreditimi FIBAA (Agjencia ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë të institucioneve) e Shkollës së lartë më jep sigurinë se do të përfitoj mirë për karrierën time në të ardhmen. Unë i vlerësoj shumë profesorët dhe pedagogët tanë kompetentë.



Enxhi Bajraktari
21, Shqipëri, Fakulteti i Biznesit dhe Teknologjisë

Ka shumë arsye pse unë kam zgjedhur Shkollën e Lartë Nehemiah Gateway dhe jo një universitet tjetër në Shqipëri. Këtu kam mundësi që çdo gjë të cilën e kam mësuar në klasë ta provoj në praktikë. Përveç kësaj, mësimi zhvillohet në Anglisht, kështu që unë mund të praktikoj dhe të përmirësoj anglishten. Universiteti është i akredituar ndërkombëtarisht. Kështu që unë mund të vazhdoj masterin jashtë Shqipërisë.



Markus Drotleff
28, Gjermani, Fakulteti i Biznesit dhe Teknologjisë

E veçanta e Shkollës së Lartë Nehemiah Gateway është për mua personalisht se teoria dhe praktika janë të kombinuara. Kjo do të më ndihmojë në rrugën time përpara. Kjo është veçanërisht interesante për mua për të bërë kontakte me kompanitë dhe bizneset dhe të takohem me njerëz profesionalisht të suksesshëm dhe kompetentë dhe të marr sugjerime nga ata. Qëllimi im është të hap një biznes në vendin tim për mbështetur veçanërisht të rinjtë për të jetuar një jetë kuptimplotë.